



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:063796

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734702

KPPP.nr.768/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" SH.A., me seli në Prishtinë rr. "Nezir Shala" kundër debitorit "Lirimi & ACL" SH.P.K., me adresë në rr. "Jakov Xoxa" p.n. me numër unik identifikues 810821860, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.523/23 të datës 19.04.2023, të Përbaruesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit "Lirimi & ACL" SH.P.K., i ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr.523/23, i lejuar me datë 19.04.2023, nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" SH.A., ka lëshuar Urdhrit Përbarimor P.nr.523/23 të datës 19.04.2023 me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, fatura me shifër K054025, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 477.79€ si dhe shpenzimet e përbarimit.

Kundër urdhrit për lejimin e përbarimit, me datë 04.05.2023 jashtë afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin ka kundërshtuar propozimin për përbarim duke kërkuar që i njëjti të anulohet dhe të aprovohet prapësimi i debitorit.

Kreditori, Brenda afatit ligjor ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e tij të paraqitura në prapësim. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i pas afatshëm, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se debitori me datë 20.04.2023 e ka pranuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.523/23, të datës 19.04.2023, nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi, , fakt ky i cili vërtetohet nga fletë-kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat e cila gjendet në shkresat e lëndës. Ndërsa, nga shkresat e lëndës, respektivisht vula e pranimit përmes postës, rezulton se debitori me datë 04.05.2023 ka paraqitur prapësimin ndaj këtij urdhri.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për procedurën përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Në mbështetje të dispozitave si më lartë, si dhe nisur nga fakti se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 20.04.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 21.04.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 28.04.2023 ditë e premtë.

Prandaj, meqë debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 04.05.2023, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pas afatshëm.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 73, paragrafi 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.768/23, datë 24.05.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.